

LIGJ
Nr. 49/2015

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NR. 4, TË MARRËVESHJES SË NDIHMËS
PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA
TË AMERIKËS, PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS DHE QEVERISJEN E
MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RITJE EKONOMIKE ME BAZË TË
GJERË, TË QËNDRUESHME DHE GJITHËPËRFSHIRËSE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi nr.4, i marrëveshjes së ndihmës për objektiva zhvillimi, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për forcimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjen e mirë dhe krijimin e kushteve për një rritje ekonomike me bazë të gjerë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.5.2015

**Shpallur me dekreten nr. 9109, datë 21.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Marrëveshje e Ndihmës së USAID-it nr. 182-DOAG-13-005

AMENDIM NUMËR KATËR

**I MARRËVESHJES SË NDIHMËS PËR OBJEKTIVA ZHVILLIMI NDËRMJET
QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR FORCIMIN E SHTETIT TË SË
DREJTËS DHE QEVERISJEN E MIRË DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE PËR NJË RITJE
EKONOMIKE ME BAZË TË GJERË DHE TË QËNDRUESHME
DATUAR 30 SHTATOR 2013**

Amendim numër katër i Marrëveshjes së Ndihmës për objektiva zhvillimi ndërmjet qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës që vepron nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave (më poshtë e quajtur "Përfutuesi i ndihmës")

Neni 1

Qëllimi i amendimit

Ky amendim numër katër i Marrëveshjes së Ndihmës së USAID-it për objektiva zhvillimi të datës 30 shtator 2013 (Marrëveshja) bëhet midis palëve me qëllim që t'i japë përftuesit të ndihmës një ndihmë shtesë prej dy milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë dollarë amerikanë (USD) (\$2,560,000) dhe të modifikojë buxhetin në përputhje me sa më sipër. Kjo shumë shtesë e fondeve e bën shumën e angazhuar të marrëveshjes deri në këtë datë, në një shumë që nuk kalon nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë (USD) (\$19,397,953).

Neni 2

Kontributet e palëve

Neni 3, seksioni 3.1 (a) i Marrëveshjes fshihet tërësisht dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

"Seksioni 3.1 Kontributi i USAID-it

a) Granti, për të ndihmuar arritjen e objekti-vave të vendosura në këtë Marrëveshje, USAID në përputhje me aktin e ndihmës së huaj të vitit 1961, siç është amenduar, i jep përftuesit të ndihmës, sipas kushteve të Marrëveshjes, një shumë që nuk kalon nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë, e nëntëqind e pesëdhjetë e tre dollarë amerikanë (USD) (\$19,397,953) (Granti).

Ky amendim nuk e ndryshon kontributin total të llogaritur të USAID-it për arritjen e objektivave, i cili mbetet njëzet e tetë milionë e pesëqind e dyzet e katër mijë dollarë amerikanë (\$ 28,544,000) siç përcaktohet në nenin 3, seksioni 3.1 (b) të Marrëveshjes.

Neni 3

Plani financiar

Plani financiar sipas shtojcës 1, përshkrimit të zgjeruar, seksioni III, fshihet tërësisht, dhe teksti në vazhdim e zëvendëson atë.

"III. Plani financiar

Plani financiar për kryerjen e objektivave dhe të rezultateve paraqitet në tabelën më poshtë:

Nr.	Fusha e programit	Viti fiskal (VF) 2014	VF 2014 i rishikuar	Totali VF 2013-2016
1	Shteti ligjor dhe të drejtat e njeriut	\$1,750,000	\$1,750,000	\$ 5,339,000
2	Qeverisja e mirë	\$3,014,000	\$3,014,000	\$11,003,000
3	Shoqëria civile	\$60,000	\$60,000	\$1,000,000
4	Tregtia dhe investimet	\$0	\$0	\$1,500,000
5	Spektori financiar	\$ 0	\$1,160,000	\$1,950,000
6	Konkurrueshmëria e sektorit privat	\$ 0	\$1,100,000	\$4,817,000
7	Infrastruktura	\$ 0	\$0	\$0
8	Mbështetje për programin	\$ 700,000	\$1,000,000	\$2,935,000
	Totali	\$5,522,000	\$8,084,000	\$28,544,000

Neni 4

Rregullat dhe kushtet e tjera

Përveç sa amenduar këtu, të gjitha rregullat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes mbeten plotësisht në fuqi. Të gjitha termat me germa kapitale në këtë amendim numër katër do të kenë kuptimet që u jepen atyre në Marrëveshje.

Në dëshmi të kësaj, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Përftuesi i Ndihmës, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që ky amendim numër katër i Marrëveshjes të nënshkruhet në emër të tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Marcus Jonson

Përfaqësuesi i USAID/Shqipëri

Këshilli i Ministrave të Republikës

së Shqipërisë

Shkëlqim Cani

Ministër i Financave